



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.52/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Dega në Podujevë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të vendosjes së flamujve në shtylla elektrike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.09.2017, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Podujevë me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes.

A r s y e t i m

Me datën 23.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV me të cilën pretendon se me datën 22.09.2017 në rrugën “Zahir Pajaziti” në Podujevë, aktivisti i tyre ka vërejtur se nëpër shtylla elektrike janë vendosur flamuj të subjektit politik LDK. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik LDK, ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës, si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Subjekti politik LDK, në përgjigje në ankesë të datës 24.09.2017, thekson se ankesa e subjektit politik LVV është i pa bazë dhe e qëllimshme, për faktin se vendosja e flamujve në shtylla të dedikuara për këtë gjë, nuk përbënë shkelje të rregullave zgjedhore, aq më tepër edhe kur Dega e LDK-së ka marrë pëlqimin paraprakisht nga Komuna e Podujevës. Si dëshmi ka bashkëngjitur vendimin e Komunës së Podujevës “Pëlqimi” me nr. 10-020-712/2017.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se flamujt e subjektit politik LDK janë të vendosur në shtylla elektrike, janë të qëndrueshme mirëpo paneli ka vlerësuar se vendosja e flamujve lëndor janë të vendosur në vendin e dedikuar për vendosjen e të njëjtëve, ashtu siç vërtetohet nga fotografit që gjenden në shkresat e lëndës.


Andaj paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme përskrimet në ankesë së është Thyer Kodi i Mirësjelljes nga subjekti politik LDK. Me këtë rast paneli konsideron, se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në mënyrë që paneli, të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e lartëcekura dhe duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Zl.Anr.52/2017 më datën 25.09.2017.

**Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.